



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.47

Prishtinë, më 18.4.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviq dhe Shpejtim Bulliqi.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues MRKS, KKTK, Iniciativa e të Rinjve "Ruaje Tënden", ChWB Kosova, NDI, OSBE, KDI, IKMM dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.3.2016;
3. Diskutimi lidhur me gjendjen në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.3.2016

Procesverbali, nga mbledhja e mbajtur më 29.3.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutimi në lidhje me gjendjen në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës

Nait Hasani, kryetar, tha se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që e mbështesin punën e Komisionit, jemi pajtuar të mbahet një diskutim lidhur me gjendjen aktuale në Trashëgiminë Kulturore në Kosovë, respektivisht me gjendjen e Hamamit të Prishtinës. Kjo me qëllim të analizimit të mundësive të mbrojtjes dhe kryerjes së punimeve në restaurimin e arkitekturës që ka Hamami i Prishtinës, me qëllim që të rikthehet në gjendjen e merituar dhe të pranueshme, po ashtu është me rëndësi që institucionet përkatëse të marrin masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dhe kulturës në vend si vlerë dhe pasuri e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Donjetë Ahmetaj, Iniciativa e të Rinjve "Ruaje Tënden" prezantoi para anëtarëve të Komisionit të gjeturat e hulumtimit të tyre me qëllim të avokimit në institucionet relevante për shpëtimin e Hamamit të madh të Prishtinës. Prishtina, si kryeqytet, ka trashëguar objekte të shumta kulturore, arkeologjike dhe arkitekturale që shumica prej tyre u shkatërruan gjatë regjimit komunist. Hamami i madh i Prishtinës gjendet në qendër të zonës së trashëgimisë kulturore dhe u ngrit qysh në shekullin XV. Në vitin 1985 u shpall monument i trashëgimisë kulturore dhe historike. Ky objekt ka për qëllim fillimin e avokimit për fillimin e punimeve konkrete për shpëtimin e Hamamit të Madh të Prishtinës. Ajo shfaq para Komisionit rekomandimet nga Iniciativa e të Rinjve, "Ruaje Tënden", si vijon:

- Të bëhet publikimi i raportit të punës së Komisionit (i cili u formua për të vlerësuar punimet e bëra në realizimin e projektit).

- Të formohet një komision nga institucionet përgjegjëse për të vlerësuar punimet e bëra gjerë më tani.
- Të merren masat e menjëhershme nga K. Prishtinës dhe MRKS për ndalimin e degradimit të mëtutjeshëm të Hamamit të Prishtinës.
- Të bëhet edhe një inspektim i ri, duke mbledhur të gjitha të dhënat nga dëmtimet e shkaktuara në Hamam.
- Të hartohet plani i Konservimit, Restaurimit, si dhe kthimit të origjinalitetit të Hamamit të Madh të Prishtinës.

Salih Morina tha se kjo iniciativë është e qëlluar dhe e rëndësishme edhe për MRKS, departamentin për kulturë, por edhe për komunën e Prishtinës, si dhe Institutin për mbrojtjen e monumenteve të kulturës. Të gjithë aktorët bashkërisht duhet të ndikojmë në prandalimin e degradimit të këtij institucioni, i cili ka një vlerë jashtëzakonisht të madhe kulturore. Do të ishte mirë që të mbahet një takim tjetër i një niveli më të lartë duke i komentuar rekomandimet e dala nga ky raport që u prezantua. Ai ngriti çështjen e licencimit të kompanive që merret drejtpërdrejt me punimet brenda monumenteve të trashëgimisë kulturore.

Sergjan Popoviq tha se e përshëndes Iniciativën e të Rinjve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, dhe vlerësoi se përveç ruajtjes së trashëgimisë kulturore, e rëndësishme është edhe edukimi i të rinjve lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që kjo është me rëndësi për identitetin e një populli. Lidhur me këtë tha se identiteti i një populli ndërlidhet me trashëgiminë kulturore dhe procesi i pajtimit dhe stabilizimit në mes komuniteteve në Kosovë duhet të vijë duke respektuar dhe ruajtur vlerat e trashëgimisë kulturore të njëri- tjetrit.

Shpejtim Bulliqi, i falënderoj përfaqësuesit nga Iniciativa e të Rinjve “Ruaje Tënden” për prezantimin duke e konsideruar këtë si nismë të qëlluar, duke shpresuar që ky raport të mos mbetet vetëm në formë të iniciativës, por të gjithë të ndikojmë në shpëtimin nga degradimi të Hamamit të Madh të Prishtinës. Këto të gjetura e prezantojnë fatkeqësisht gjendjen që është trashëgimia kulturore në të gjithë Kosovën. Në bazë të prezantimit vërehet një shumë relativisht e madhe, rreth 700.000 euro të mjeteve, të cilat janë shpenzuar në këtë projekt. Është një përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe e insitucioneve të cilat e kanë menaxhuar dhe mbikëqyrur

këtë proces. Ai gjithashtu ngriti çështjen e mundësisë së përfshirjes së Këshillit për Trashëgimi Kulturor në iniciativë të tilla, duke qenë se Këshilli mund të ndikojë në këtë proces.

Gjejlane Hoxha tha se raporti i Iniciativës së të Rinjve paraqet të gjeturat e tyre nga hulumtimi i bërë lidhur me punimet e kryera në Hamamin e Prishtinës. Këto të dhëna tregojnë për një punë joprofesionale që është bërë në Hamamin e Prishtinës. Hamami i Prishtinës është vepër arkitekturore e një sulltani- Sulltan Mehmet Fatihu. Rëndësia e këtij hamami është e nivelit ndërkombëtar. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulutore ka punar një ekspertizë, në vitin 2013, duke dhënë kështu sugjerimet konkrete të bazuara në ligj dhe i ka dërguar tek institucionet relevante. Duke ndikuar kështu në masat që duhet të ndërmerren për shpëtimin e Hamamit të Prishtinës dhe vënies në funksion të tij. Duhet të jepet përgjegjësi publike për shpenzimet e gjitha mjeteve që janë të një rëndësie të ultë krahasuar me dëmët që i janë bërë Hamamit të Prishtinës dhe zhbërjes së autenticitetit të tij. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor ka një përgjegjësi ligjore të bashkëpunojë me të gjithë akterët për themelimin e një projekti të ri për restaurimin dhe adaptimin e Hamamit të Prishtinës në rrethana bashkëkohore.

Nol Binakaj, përfaqësues i organizatës “Trashëgimia Kulturor pa Kufij (CHWB)” tha se si organizatë kemi qenë iniciatorë që Hamami i Prishtinës të mbrohet dhe restaurohet, po ashtu kemi qenë të përfshirë në mbikëqyrjen e procesit të restaurimit deri në momentin e degradimit. Një nga shkaqet e kësaj gjendje është se institucionet relevante që janë marrë me projektin, kanë qenë anëtarë edhe të kompanive punuese duke i miratuar punët që i kanë kryer vetë. Është i rëndësishëm funksionalizimi i një organi mbikëqyrës për punët brenda Hamamit të Prishtinës. Tani, pasi Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor është funksional, i ka të gjitha mundësitë që të ndihmojë edhe MRKS, por edhe vendin në përgjithësi me një planifikim dhe strategji të mirëfilltë se si t’i qasen këtij monumenti të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore.

Fatir Berzati tha se qëllimi i këtij raporti nuk është vetëm mbrojtja e Hamamit të Prishtinës, por fillimi i një procesi mbrojtës për të gjitha monumentet e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Pasi aktualisht këto monumente nuk janë në mbrojtje nga shteti, që është kusht i pjesëmarrjes në UNESCO dhe organizata të tjerë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Nait Hasani tha se lidhur me rekomandimet e dala nga hulumtimi i Iniciativës së të Rinjve “Duaje Tënden” lidhur me restaurimin dhe konservimin e Hamamit të Madh të Prishtinës, si dhe sugjerimet e dala nga takim, Komisioni në një nga mbledhjet e radhës do të ftojë përfaqësuesit e MKRS, të KKTK, si dhe institucionet e tjera të fushës së trashëgimisë kulturore me qëllim të adresimit të kësaj çështje.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani